



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 5849/1, Prot.

Tiranë, më 25 . 11 .2019

L ë n d a : *Kthim përgjigje.*

**PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SHKËLQESISË SË TIJ ZOTIT ILIR META**

TIRANË

I nderuar Zoti President,

Në përgjigje Tuajës nr.4329/1 prot., datë 22.11.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.5849, datë 25.11.2019, për sa nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkohet, Ju informojmë për sa më poshtë:

Së pari, listat e kandidatëve, nga radhët e gjyqtarëve, që plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2020, sikundër edhe listat e kandidatëve që nuk plotësojnë këto kushte, në përputhje me detyrimin e përcaktuar në nenin 221, pika 4, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, janë publikuar rregullisht, më datë 15.11.2019, në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së dyti, kandidatët e përjashtuar, nga radhët e gjyqtarëve, në përputhje me detyrimin e përcaktuar në nenin 221, pika 5, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, janë njoftuar me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

Së treti, nga kandidatët e përjashtuar, nga sa Këshilli i Lartë Gjyqësor është njoftuar zyrtarisht deri në këtë moment nga Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 221, pika 5, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, është paraqitur ankim vetëm nga z.Medi Bici, i cili aktualisht është anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së katërti, për ankimin e paraqitur nga z.Medi Bici nuk ka ende një vendim përfundimtar nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa seanca për shqyrtimin e ankimit nga kjo gjykatë është caktuar për më datë 26.11.2019.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARE


NAUREDA LLAGAMI
